



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Praktikum në fushë: veprimtari e bazuar në mësimdhënien dhe të nxënë

Ngarkesa: 6 Kredite (=125 orë mësimore);

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Profesional, Përkthim me profil përkthyes

Kodi i etikës: Kodi i etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të zhvillojë aftësitë profesionale të studentëve në përputhje me profilin përkthyes të programit të studimit. Të nxisë zbatimin praktik të njohurive teorike të përvetësuara gjatë studimeve. Të ndihmojë studentët të njohin mjedisin profesional dhe të përshtaten me kërkesat e tregut të punës.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të aftësohen në menaxhimin e përkthimeve reale brenda afateve të caktuara nga institucionet pritëse.
2. Të zhvillojnë aftësi bashkëpunuese dhe të komunikimit profesional në një mjedis pune.
3. Të ndërgjegjësohen për rëndësinë e etikës profesionale, përfshirë ruajtjen e konfidencialitetit dhe respektimin e rregullave institucionale.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të aplikojnë në mënyrë të saktë strategji dhe teknika përkthimore në përkthime reale.
2. Do të demonstrojnë aftësi për të funksionuar në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunuese në një institucion ose kompani reale.
3. Do të tregojnë përgjegjshmëri profesionale përmes respektimit të etikës së punës dhe rregullave të institucionit pritës.